



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:158434

Datë: 11.03.2024

Numri i dokumentit: 05433217

P.nr.691/2018

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni penal, me gjyqtarin Xhemajl JUSUFI, me zyrtaren ligjore Doruntina BEKA, në çështjen penale kundër të akuzuarit B...G... për shkak të veprës penale Vjedhje nga neni 325 paragrafi 1 të Kodit Nr.04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës (tutje si: KPRK), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.2303/18 të datës 30.08.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 07.03.2024 në prezencë të Prokurorit të Shtetit Muharrem Prekazi dhe të pandehurit B...G..., me datë 08.03.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 11.03.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

B...G..., me nofkën "V...", nga i ati I..., e ëma S..., e gjinisë R..., i lindur me datë 19.01.1970 në Mitrovicë, ku edhe tani jeton në Rr. "Z... P..." nr., me numër personal, i pa punë, i martuar, baba i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse,

Me datën 08.06.2018 rreth orës 16:10 në Mitrovicën Veriore në Rr. "S...", në qebaptoren "K... S..." e ka shfrytëzuar mos kujdesin e të dëmtuarës J..... S....., nga karriga në të cilën ishte vendosur qesja e të dëmtuarës, e ka nxjerrë kuletën ku pas kësaj është larguar nga vendi i cekur ku të hollat nga kuleta në vlerë prej 125 euro i ka marrë dhe kuletën me dokumente personale e të dëmtuarës i kishte lënë para qebaptores.

Me këtë ka kryer veprën penale Vjedhje nga neni 325 paragrafi 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të nenit 1, 4, 7, 17, 21, 41, 42, 43, 45, 46, 73, 74 dhe 325 të KPRK-së, dhe nenit 242, 364, 449, 450, 452 dhe 462 të KPP-së e:

G J Y K O N

- I. Dënim me burgim në kohëzgjatje prej njëqind e pesëdhjetë (150) ditë, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.
- II. Dënim me gjobë në shumë prej 300 euro (*me fjalë: treqind*), të cilin dënim është e obliguar që ta paguaj në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.
- III. Obligohet i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej njëzetë euro (20) si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit të paguajë shumën prej njëzetë euro (20), të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.
- IV. Pala e dëmtuar, J.... S...., me adresë të vendbanimit D....., K....., Serbi, për realizimin e kërkesës pasurore – juridike, udhëzohet në kontest të rregullt juridiko - civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur Aktakuzën PP.II.nr.2303/18 të datës 30.08.2019, kundër të pandehurit B...G.... për shkak të veprës penale Vjedhje nga neni 325 paragrafi 1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datën 07.03.2024, në të cilën kanë qenë të pranishëm prokurori i shtetit Muharrem Prekazi, i pandehuri B...G.....

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit, i pandehuri ka deklaruar se e ndjen veten fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet, se e kupton natyrën dhe pasojat juridike të pranimin të fajësisë, pranimin e fajësisë e bënë në mënyrë vullnetare, pa presion dhe pas sqarimeve të mjaftueshme nga ana e gjykatës për pasojat dhe benefitet e pranimin të fajësisë. Gjithashtu deklaroi se i vjen keq për rastin që ka ndodh dhe e njoftoi gjykatën se nga shuma që i ka marrë të dëmtuarës një pjesë të parave ia ka kthyer, i njëjti kërkon nga gjykata që t'i shqiptoj një dënim sa më të butë.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se: konsideron se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë, pranimi është bërë në mënyrë vullnetare, pa presion dhe pranimi mbështetet në provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës, ndërsa lidhur me sanksionin penal, gjykatës i ka propozuar të marrë parasysh rrethanat rënduese dhe lehtësuese me qëllim të arritjes së qëllimit të dënimit, ku si rrethanë lehtësuese të merret parasysh pranimi i përgjegjësisë penale si në deklaratën e dhënë në polici ashtu edhe në shqyrtim fillestar.

Gjykata ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e ka deklaruar i pandehuri, e në mbështetje të nenit 248 të KPP-së, në këtë drejtim vlerëson se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të njëjtin. Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit, mbështetet në provat me të cilat disponon kjo gjykatë si: deklarata e të dëmtuarës e datës 08.06.2018 dhënë në SP Mitrovicë Veri, deklarata e të pandehurit e datës 19.06.2018 dhënë në SP Mitrovicë Veri, foto dokumentacioni, lista e sendeve të konfiskuara si dhe shkresat e tjera të lëndës. Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë e tyre dhe pranimin të fajësisë, konsiderojmë se për tej çdo dyshimi është vërtetuar se i akuzuari, ka kryer veprën penale që i vihet në barrë.

Gjykata ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë në mënyrë vullnetare, dhe se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, duke iu tërhequr vërejtja të pandehurit se pas pranimin të fajësisë, ai nuk mund të bëjë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, por vetëm sa i përket llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë se të pandehurit dhe nga provat e cekura si më lart, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale Vjedhja nga neni 325 paragrafi 1 të KPRK-së, për të cilën veprën penale parashihet dënimi me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së. Rrethana rënduese lidhur më këtë rast, gjykata vlerëson rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, dashjen e kryesit, si dhe fakti se i njëjti është recidivist. Kjo bazuar në të dhënat nga evidenca për të kaluarën kriminale të pandehurit, nga ku vërtetohet se i njëjti ka qenë edhe më parë i dënuar me katër (4) aktgjykime të formës së prerë dhe atë përmes: Aktgjykimit P.nr.598/2017, i plotfuqishëm me datë 12.12.2017; Aktgjykimit P.nr.247/2014, i plotfuqishëm me datë 11.02.2015; Aktgjykimit P.nr.574/2017, i plotfuqishëm me datë 28.03.2019 dhe Aktgjykimit P.nr.788/2019, i plotfuqishëm me datë 30.06.2022. Në të gjitha këto raste, i pandehuri është dënuar për veprën e njëjtë penale, pra veprën penale të vjedhjes, çka dëshmon se i njëjti është përsëritës i veprave penale dhe për më tepër, i veprave penale të natyrës së njëjtë, çka dëshmon për karakterin dhe prirjet e të pandehurit.

Ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata e ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprën penale, sjellja korrekte e të pandehurit në gjykatë, kohën e kaluar nga kryerja e veprës penale pasi që tashmë kanë kaluar pothuajse gjashtë vite nga kryerja e saj si dhe keqardhjen e shprehur nga i pandehuri.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata vlerëson se shqiptimi i dënimit me burgim dhe i dënimit me gjobë ndaj të pandehurit, janë dënime të drejta, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Po ashtu, Gjykata vlerëson se me këto dënime do të arrihet qëllimi i dënimit nga

neni 41 të KPRK-së, që t'i parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. Po ashtu, ky dënim do të shërbejë si masë preventive që në të ardhmen i pandehuri të përmbahet nga çfarëdo veprimi që është i dëmshëm për shoqërinë në përgjithësi.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449, 450 dhe 452 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e paushallit Gjyqësor, ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 36 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit nr.08\L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Gjykata ka vendosur që palën e dëmtuar ta udhëzoj në kontest të rregullt juridiko civil, duke u bazuar në nenin 462 të KPP-së, kjo për faktin se nga të dhënat në lëndë, nuk kishte bazë të sigurt për detyrimin e të pandehurit për kompensimin e këtij dëmi ndaj të dëmtuarës.

Andaj, gjykata duke u bazuar në nenin 242, 364, 449, 450, 452 dhe 462 të KPP-së, nga arsyet e lartcekura, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.691/18, datë 11.03.2024

Procesmbajtësja
Doruntina BEKA

Gjyqtari
Xhemajl JUSUFI

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të Aktgjykimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për Gjykatën dhe palët kundërshtare.